

## II. krijimi i ueb faqeve dhe bazat e punës me ueb faqe

### Krijimi i ueb faqes së re brenda ueb sajtit

1. Hapeni ueb




2. Zgjidhni **File | New** ose përmes ikonës **New** zgjidhni *Page*:

Në panel në pjesën e djathtë të ekranit zgjidhni nën "New page" **Blank Page**

3. Hapet faqja e re e pa emëruar të cilën duhet ruajtur nën emrin e caktuar.

### Ruajtja e faqes

1. zgjidhni komandën **File | Save** (ose **File | Save As**) ose tastin 
2. emërtoni faqen e parë të ueb sajtit si *index.html* (ose *indeks.htm*), ndërsa të tjerat sipas dëshirës ku duhet patur kujdes që mbrapashtesa e fajllit .htm ose html. Faqja me emër *idex.html* paraqet faqen titullare (hyrëse- *home page*) të ueb sajtit.


**Vërejtje :** tek emërtimi i faqeve më së miri të përdoren shkronjat e **vogla** të alfabetit, numrat dhe shenja\_(për nënvizim), e **JO** shenjat shqip dhe **JO** përdorimi i zbrastirës (*space*) dhe shenjat speciale. P.sh në Vend të faqes "faqja ime e pare.htm " ta quani "faqja \_ime\_e\_pare.htm"

**Detyrë:** hapni ueb sajtin "**tik**" (nga ushtrimi paraprak ) dhe krijoni 4 ueb faqe që do queni:

*index.htm, hyrje.htm, tekst.htm, grafika.htm*

### Mbyllja e ueb faqeve


Ueb faqja mbyllet me klik në **X** këndin e djathtë të sipërm të faqes:



## Hapja dhe zgjidhja e ueb faqes

Faqja e cila i përket ueb sajtit më së thjeshti e hapemi ashtu që në listën e follderëve (*Folder list, folders*) nga e majtë klikojmë 2 herë në emër faqes/fajllit që dëshirojmë ta hapim.

Në të njëjtën kohë mund të jenë të hapura më shumë faqe, ndërsa zgjedhim faqen me të cilën dëshirojmë të punojmë (faqen aktive) me klikim në emrin saj në ballin :



Në pamje Ylli (\*) lajmërohet në emrin atyre ueb faqe të cilat nuk janë të ruajtura pas ndryshimeve të fundit.

**Detyrë:** mbyllni dhe **sërisht** hape faqen *tekst.htm*

Si faqe aktive zgjidhni *hyrje.htm*

## Fshirja e faqes

Faqja e cila i përket ueb sajtit e fshijmë ashtu që në listën follder (*Folder list*) nga ana e majtë e markojmë ( me një klik ) emrin e faqes/fajllit që dëshirojmë ta fshimë dhe shtypim tastin **Del**.

(faqen mund ta rrimërojmë ashtu që në të klikojmë njëherë dhe e shkruajmë emrin e ri.)


**Detyrë:** krijoje një ueb faqe të re *perkoshme.htm* dhe të njëjtën më pas fshije.

## Ndërfutja dhe fshirja e tekstit në ueb

Teksti në ueb faqe në programin FrontPage ndërfutet dhe fshihet njëjtë MS Worda.

Pos shkrimit të tekstit, mund shfrytëzohet kopjimi i tekstit me ndihmën e komandës Copy/Paste.

**Vëretje:** me rastin e kopjimit të tekstit në FrontPage ruhet formatizimi original i tekstit. Këtë më së shpeshti ne nuk e dëshirojmë pasi së fundi vetë do ta redaktojmë tekstin, zgjidhim opsionin "*Keep Text Only*" me klikim në ikonën e cila lajmërohet në këndin e majtë poshtë tekstit të kopjuara:



nëse dëshirojmë të heqim dorë nga komanda për kopjim (ose të cilës do komand tjetër) do të zgjidhmi komandën: **Edit | Undo**.

**Detyrë:**

Hapne (ose vendose si aktive) ueb faqen *hyrje.html*.

Në faqe shkruane tekstin :

"Nocioni (multimedia) vie nga fjala latine multus (shumë) dhe medium (medium ) dhe paraqet integrimin të elementeve medium të ndryshme të cilët në thelb janë përmbajtje të pavarura.

Multimedia është informacioni i paraqitur ose i ruajtur në kombinim të tekstit, grafikës, zërit, animacionit dhe videos të bashkuar me anë të kompjuterit.

Elementet kryesor mediatikë janë:

teksti

grafika

zëri


animacioni

video.

**Detyrë:**

Hape (ose vendosni si aktive) ueb faqen *tekst.html*. në faqe kopjoni tekstin i cili ndodhet në adresën <http://ahyco.ffri.hr/apuri/tekst.htm> nën pikën 1. vendosja e tekstit në kompjuter.

## Mënyra e paraqitjes së ueb faqeve

Paraqitjen e faqes zgjedhni me ndihmën e shiritit nën faqe: 

1. **Design** – ndërftuje e tekstit fotografive, hiperlidhjeve, tabelave, ... në mënyrë të ngjashme si tek MS Word-i
2. **Code** – paraqitja e faqes me etiketat HTML
3. **Split** – ndan faqen në dy pjesë: në të sipërm janë etiketat HTML , ndërsa në të poshtmen paraqitja Design .
4. **Preview** – faqja duket si në browser .

**Vërejtje** : faqet para se të publikohen në ueb server duhet shiqohen me ndihmën e brovsere (MS Intrnet Explorer ose/dhe Mozilla Firefox)

**Detyrë:**


Ueb faqen *hyrje.html* hape dhe shikoje në 4 paraqitje . Hape browserin MS Internet Explorer dhe në te shikoje faqen.

## Titulli kryesor i faqes (*title*)

Titulli kryesor i ueb faqes lajmërohet në shiritin e dritares për titull të Ueb browserit titulli duhet të jetë i shkurt dhe i qartë dhe unik ta përcakton ueb faqen.

1. zgjidhni nga zgjedhja **File | Properties** (ose klikoni me tast të djathtë në faqe dhe zgjidhni **Properties**)

2. zgjidhni kartelën **General** dhe nën **Title** shkruani titullin e faqes . Në fund klikoni **OK**.



**Detyrë:** ndryshoni titujt kryesor të ueb faqeve në ueb sajt "**tik**":

*index.htm* - sistemet Multimediale

*hyrje.htm* - hyrje në sisteme multimediale

*tekst.htm* - digjitalizimi i tekstit

*grafika.htm* - Grafika në kompjuterë

përmes browserit(shfletuesit) MS Internet Explorer vërtetoni se a janë vendosur titujt mirë.